



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN**  
**DREJTORATI I INSPEKTORATIT**



**DREJTORATI I INSPEKSIONIT**

<b>Datë :</b>	<b>03.09.2024</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/9</b>
<b>Për :</b>	<b>Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës</b>
<b>Nga:</b>	<b>Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit</b>
<b>Lënda :</b>	<b>Raporti i muajit-shtator</b>

## **PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

Gjatë muajit shtator Drejtoria e Inspektoratit ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- objektivë e inspektimit gjatë këtij muaji nga inspektorët e tregut ka qenë: inspektimi i furrave bukës, mullinj të grurit, lidhur me regjistrimin e biznesit, pranimin teknik, gramazha, çmimet e deklaruara dhe çertifikimi i kalibrimit të peshoreve.

Inspektorët e tregut kanë bërë inspektime të subjekteve të ndryshme afariste të cilat nuk janë të regjistruara në ARBK si dhe biznese të cilët nuk kanë pranime teknike. Të gjitha këto biznese janë urdhëruar me procesverbal të bëjnë regjistrimin në ARBK dhe të aplikojnë për pranim teknik të lokalit afarist.

Në bazë të kërkesave nga bizneset janë bërë pranime teknike të lokaleve afariste.

Është bërë inspektim i marketeve ushqimore lidhur me vendosjen çmimeve, krahasimin e çmimeve raftë-arkë, vendosja e flamujve tregus të origjinës së mallit. Në bizneset ku nuk kanë qenë të vendosura çmimet dhe flamujt është iniciuar procedurë kundevajtëse.

Është realizuar inspektimi i vazhdueshëm i tregjeve si: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobileve (nuk është lejuar asnjë lloj shitje jashtë tregut).

Inspektori i mjedisit-ambientit- Janë inspektuar deponitë ilegale të mbeturinave në fshatrat si në Glllogovc, Slllovi Smallushë Gadime e Ulët, Shalë, Kodrën e Kërçevës për të marrë masa ligjore ndaj atyre që takohen, apo gjendet ndonjë dëshmi për ndotjen e mjedisit.

Janë inspektuar objektet ndërtimore që janë duke u ndërtuar, ato me shumë njësi banimi dhe afarizëm në qytetin e Lipjani, si dhe objektet e ndryshme të bizneseve në rrugët magjistrale Prishtinë-Ferizaj, objektivë e inspektimit ishte zbatimi i kushteve të lejes mjedisore komunale, grumbullimi i mbeturinave (vendosja e tyre në kontejner). Për parregullsitë e gjetura janë dhënë urdhëresa që ato të evitohen brenda afatit të caktuar.

Janë pranuar ankesa për hedhje të mbeturinave në pronë private nga një biznes e cila është duke bërë pastrimin e shtratit të Lumit Janjevka në Janjevë projekt nga MMPH dhe Infrastrukturës, ndaj firmës janë marrë masat e caktuara ligjrisht për largimin e mbeturinave të hedhura në pronë private.

Ankesa kishte edhe për probleme me kanalizim në fshatin Gadime e Epërme, kontrolla është bërë në teren dhe lënda është dërguar në kompetencë tek drejtoria përkatëse.

Është bërë ri-kontrollë në fshatin Smallushë, për zbatimin e urdhëresës së dhënë ndaj një personi fizik për mbeturinat inerte të hedhura në pronën publike, mbeturinat inerte ishin larguar nga personi fizik fshati Smallushë

Inspektorët e trafikut- objektivë e inspektoreve të trafikut ka qenë inspektimi i kompanive të autobusëve, auto-taksive si dhe kombi-taksi ilegal.

Janë bërë inspektime në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” me objektivë kontrolli i kompanive radio-taksi të cilat kompani posedonin licence, mirëpo nuk i përmbaheshin licencës.

Inspektori i ndërtimit- janë realizuar inspektime të vazhdueshme në teren. Janë inspektuar objekte të cilat posedojnë leje ndërtimi dhe është konstatuar gjendja e tyre me procesverbal, si dhe ndaj ndërtimeve të filluara pa leje ndërtimi është konstatuar gjendja me procesverbal. Janë realizu, procesverbale, fletëparaqitje dhe vendosje të shiritave.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjgur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët, ankesat kanë qenë të shkruara, elektronike, si dhe përmes telefonatave.

## **PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE**

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit shtator janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste, si dhe janë bërë pranime teknike të lokaleve afariste.

Janë inspektuar marketet ku janë kontrolluar çmimet e artikujve ushqimor në rafta dhe çmimet në arkës (krahasimi i çmimit raft-arkë).

Inspektimi i furrave të bukës.

Inspektimi i mullinjeve të grurit.

Inspektimi ndaj veprimtarisë ilegale (shitje ambulante në sheshin “Adem Jashari”).

Është bërë inspektimi i tregjeve, ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Inspektimi i auto-taksive në qytetin e Lipjanit.

Inspektimi i auto-taksi dhe kombi-taksi ilegal.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

## STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime për objektet e legalizuara nga DPUMM-ja	Vendosje të shiritave	Njoftime nga DPUMM	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Barazim i të hyrave nga pranimet teknike te lokaleve afariste	Lënd te ekzekutuara nga Gjykata	Të hyra nga pranimet teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektime për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	158	21	8						66	19			250€	11	12	14			7
Ambienti	35	8						3	6							11	7		
Ndërtimi	51	17			2	2	9	8		13									
Trafiku	60	10						26	14	1					9				
Gjithsej	304	56	8		2	2	9	37	86	33			250€	11	21	25	7		7

## **DISKUTIMET PUBLIKE**

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

## **TAKIME TË TJERA**

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

## **SFIDAT**

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

## **REKOMANDIMET**

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.

